



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of
Kosovo

*Qeveria – Vlada –
Government*

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i
Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sport

Prishtinë, 3 gusht 2022

THIRRJA PËR PROJEKT PROPOZIME PËR VITIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2022

Mundësi të Barabarta për të gjithë

ART, TRASHËGIMI KULTURORE, RINI

Në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Nr.08/46, të datës 30.11.2022), përmes së cilit viti 2022 shpallet 2022- Vit i personave me aftësi të kufizuara - Mundësi të Barabarta për të gjithë. Përmes këtij veprimi synohet Avancimi i standardeve të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, duke siguruar përkushtimin dhe garantimin e Qeverisë, Kuvendit dhe Institucioneve vendore në përmirësimin të kuadrit ligjor për të drejtat dhe liritë të personave me aftësi të kufizuara.

Me shpalljen e vitit 2022, vit i personave me aftësi të kufizuara, Qeveria e Kosovës, Ministrinë dhe Organizatat të cilat përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara synojnë të mobilizojnë resurset e tyre për të trasuar rrugën për një Kosovë pa pengesa dhe për të fuqizuar personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të mund të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha sferat e shoqërisë.

Kalendari i aktiviteteve për vitin 2022, merr parasysh diversitetin e aftësisë së kufizuar që përfshin dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore të cilat shpesh janë të padukshme, prandaj ky kalendar përmban një grup ambicioz të aktiviteteve në fusha të ndryshme dhe ka prioritet të shumta të cilat me bashkëpunim të ngushtë në mes të institucioneve të Kosovës dhe organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara synohet të realizohen gjatë vitit 2022.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në kuadër të fushëveprimit të saj, në fushën e artit, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit, krahas objektivave të përgjithshme për fuqizimin e skenës kulturore, rinisë dhe zhvillim të sportit, për vitin 2022 rendit ndër prioritetet programore edhe integrimin e temës së Aftësisë së kufizuar, me qëllim të ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë.

Në funksion të prioritetit programor, thirrja për projekt-propozimet për vitin e personave me aftësi të kufizuar, synon mbështetjen e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve që zhvillohen në Republikën e Kosovës, të cilët përmbushin objektivat e përgjithshme si në vijim:

- Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar duke ofruar mundësi të barabartë në jetën kulturore;
- Fuqizimi i personave dhe të rinjve me aftësi të kufizuar përmes pjesëmarrjes aktive në jetën kulturore;
- Ngritja e kapaciteteve dhe shkathtësive të rinjve me aftësi të kufizuar për të siguruar një përgatitje adekuate për tregun e punës;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të personave me aftësi të kufizuar, në fushën e sigurimit të fondeve;
- Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve me aftësi të kufizuar në jetën kulturore brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, me theks tek fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara;

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithë-përfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, të moshuarit, vajzat dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë, etj.

Të drejtë aplikimi me projekt-propozime në thirrjen publike për vitin 2022 kanë OJQ-të dhe Individët që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore. OJQ-të dhe Individët mund të aplikojnë në kategorinë në vijim:

1. Projektet dhe ngjarjet në kuadër të Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2022, fushën e artit, trashëgimisë kulturore dhe rinisë;

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Vlerësimi përmbajtësor, që vlerëson

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Nëse aplikuesi ka respektuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit përkatës në vitet paraprake;

- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt- propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Aplikimi:

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në web-faqen e MKRS-së: www.mkrs-ks.org.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Sheshi Nëna Terezë; Zyra e Arkivës, Nr. 22; 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës është i detajuar në Udhëzimet për aplikuesit.

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (e shtypur dhe CD)
2. Formulari i Propozim buxhetit (e shtypur dhe CD)
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur dhe CD)
4. F12 Formular i deklaratës se partneritetit.doc (e shtypur nëse aplikohet)
5. F13 Forma e deklaratës se projekteve te financuara. docx(e shtypur dhe CD)
6. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit, dhe certifikata e nr fiskal si dhe dëshmia mbi llogarinë bankare(e shtypur).
7. Dokumentacioni për Individët e angazhuar: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale

Aplikimi i Individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrje publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (e shtypur dhe CD)
2. Formulari i Propozim buxhetit (e shtypur dhe CD)
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur dhe CD)
4. Dokumentacioni për Individ: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale(diploma/certifikata përkatëse), si dhe dëshmia mbi llogarinë bankare(e shtypur).

Afati për aplikim:

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën: **24 gusht 2022, në ora 16:00.**

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: keshnik.xharra@rks-gov.net; milot.mustafa@rks-gov.net; burim.mexhuani@rks-gov.net; jehona.shyti@rks-gov.net;

KATEGORIA E PARË:

Projektet dhe ngjarjet në kuadër të Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2022, fushën e artit, trashëgimisë kulturore dhe rinisë

Kultura dhe sporti luajnë rol tejet të madh duke ju mundësuar personave me aftësi të kufizuara të shoqërohen me bashkëmoshatarët, të jenë pjesë e ekipeve dhe aktiviteteve të ndryshme gjë që i bën të ndjehen të pa-diskriminuar.

Për këtë arsye Institucionet vendore, në veçanti Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë njësoj si gjithë të tjerët në jetën kulturore në vend. Për këtë qëllim duhet të ndërmarrën masat e duhura për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë qasje në materialet kulturore në të gjitha formatet e arritshme për ta;

- të gëzojnë qasje në programet televizive, filmat, teatrot, dhe aktivitete të tjera kulturore;
- të gëzojnë qasje në institucionet të cilat ofrojnë shërbimet kulturore, si p.sh: teatrot, muzetë, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët si dhe;
- të gëzojnë qasje në monumentet dhe qendrat me rëndësi për kulturën kombëtare.

Për këtë qëllim në Kalendarin e Aktiviteteve për Vitin e Aftësisë së Kufizuar 2022, në kuadër të fushës së Kulturës dhe Sportit janë paraparë aktivitete që ndahen në sektorë: sporti, teatri, muzeu, biblioteka, filmi, ngritja e kapaciteteve, dhe rinia.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve të për zbatim të aktiviteteve nga Kalendarin e Aktiviteteve për Vitin e Aftësisë së Kufizuar 2022, si ne vijim:

1. TEATRI

- 1.1. Organizimi i një Shfaqje teatrore në gjuhën e Shenjave;
- 1.2. Përgatitja e një shfaqje, me skenar teatror me temën: Ngritja e vetëdijes për mundësi të barabarta për të gjithë”, dhe shfaqja e saj në Teatrin Kombëtar të Kosovës, ose në Teatrot publike të qyteteve të Kosovës.

2. FILMI

- 2.1. Organizimi i javës së filmit për Persona me Aftësi të Kufizuara (me temë aftësinë e kufizuar). Filmat ekzistues botëror me temë apo personazhe me aftësi të kufizuara shfaqen për 7 ditë në një kinema e cila ka qasje për personat me aftësi të kufizuara;
- 2.2. Realizimi dhe shfaqja e një Film dokumentar apo filmi të shkurtë me temë “Aftësinë e Kufizuar”;

3. NGRITJA E KAPACITETEVE

- 3.1. Hartimi dhe zbatimi i Programeve për ngritjen e kapaciteteve për hartim, zbatim dhe menaxhim të projekteve të organizatave dhe individëve me nevoja të veçanta për aplikim në fondet publike;

4. RINI - Mbështetja e aktiviteteve për të rinj me aftësi të kufizuara

- 4.1. Organizimi i një kampi për të rinj në të cilin do të bëhet prezantimi i kulturës së të shurdhërve dhe gjuhës së shenjave (me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse);
- 4.2. Mbështetja e “Kuizit të diturisë” për të rinjtë me aftësi të kufizuara;
- 4.3. Mbështetja e Projekteve për industri kreative – artizanale;

4.4. Mbështetja e programeve të trajnimit për të rinjtë me aftësi të kufizuar (përmes programeve të trajnimit për “soft-skills”);

Shënim: Aplikuesit duhet të dërgojnë propozime për zbatimin e aktiviteteve të shënuara si më sipër.

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën e artit, trashëgimisë kulturore, rinisë me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës dhe rinisë, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Individët shtetas të Republikës së Kosovës apo shtetas të huaj pjesëtarë të diasporës kosovare, të profilizuar në fushën e artit, trashëgimisë kulturore dhe rinisë, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës dhe rinisë, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora sipas legjislacionit ekuivalent për regjistrimin e organizatave jo-për-përfitim në vendin përkatës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-të e diasporës të regjistruara në vendin e huaj;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Nga kjo pikë përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021);*
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ -të duhet të jenë të profilizuar në fushën e aftësisë së kufizuar, me përvojë të dëshmuar në organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore. Në vlerësim mund të konsiderohet edhe përvoja individuale e anëtarëve të organizatës nëse OJQ-ja është themeluar rishtazi.
- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e artit, trashëgimisë kulturore, dhe/ose rinisë me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve kulturore dhe rinore. Në vlerësim mund të konsiderohet edhe përvoja individuale e anëtarëve të organizatës nëse OJQ-ja është e themeluar rishtazi);
- Të ofrojnë portofolin me dëshmi të aktiviteteve në fushën e kulturës dhe/ose rinisë, gjatë të paktën 2 viteve të fundit;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (skema organizative, stafi-CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);
- Të ofrojnë pasqyrat financiare për të paktën 2 vitet e fundit, përkatësisht vitet 2020 dhe 2021;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Nga kjo pikë përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021);*
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se një projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

Kriteret e veçanta për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e artit, trashëgimisë kulturore, rinisë, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve kulturore dhe/ose rinore;
- Të ofrojnë portofolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e artit dhe/apo trashëgimisë kulturore , dhe/apo rinisë, gjatë 2 viteve të fundit;

- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (skema organizative, stafi-CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 15,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 5,000.00 Euro